

Çfarë duhet të dijnë prindërit dhe kujdestarët rreth platformës

INSTAGRAM

Instagrami është një nga platformat më të popullarizuara të rrjeteve sociale, me mbi 1 miliard përdorues në botë. Platforma ua lejon përdoruesve të ngarkojnë fotografi dhe video në përditësimin e tyre, të krijojnë 'tregime' interaktive, të shpërndajnë transmetime të drejtpërdrejta, të shkëmbejnë mesazhe private apo të kërkojnë, eksplorojnë dhe ndjekin llogari tjera të cilat i pelqejnë – përdoruesit në të njëjtën kohë përditëson dhe shton vazhdimisht veçori të reja për të përmbushur nevojat e përdoruesve të tij.

Cilat janë rreziqet?

VARËSIA

Shumë platforma të mediave sociale janë krijuar në një mënyrë për të na mbajtur të angazhuar në to për sa më gjatë që të jetë e mundur. Ekziston një dëshirë për të lëvizur shpesh/më shumë në rast se kemi humbur diçka të rëndësishme ose frika për të humbur. Instagrami nuk është ndryshe dhe të rinjtë mund të humbasin lehtësisht gjurmët e kohës duke lëvizur pa qëllim dhe duke parë video të postuara nga miq, të njohur, influencers apo edhe të panjohur.

ETIKETIMI I PRODUKTIT

Etiketat e produkteve i lejojnë përdoruesit (veçanërisht ndikuesit që sponsorizohen për të reklamuar produktet) të etiketojnë një produkt ose biznes në postimin e tyre. Kjo etiketë i çon shikuesit, pavarësisht nga mosha, drejtpërdrejt në faqen e detajeve të produktit në dyqan ku mund të blihet artikulli, ku fëmijët mund të inkurajohen nga influencersit për të blerë produkte që nuk u duhen domosdoshmërisht.

PËRJASHTIMI DHE OSTRACIZMI

Të rinjtë janë shumë të ndjeshëm ndaj ostracizmit. Ndjenja e përjashtimit mund të vijë në shumë forma si: të mos marrësh shumë 'pëlqime', të mos etiketohesh, të mos kesh miq, të kesh një foto të paetiketuar ose të mos marrësh një koment ose një përgjigje në mesazhin tënd. Të qenët i përjashtuar në internet dhemb po aq sa të përjashtuarit jashtë internetit – me fëmijët që mund të mos jenë në humor të mirë, të vuajnë nga vetëbesimi i ulët, duke u ndjerë sikur nuk i përkasin apo janë të nënvlerësuar.

LLOGARITË PUBLIKE

Etiketimi i produktit në Instagram është i mundur vetëm për llogaritë publike. Nëse fëmija juaj dëshiron të shpërndajë stilin e veshjes, makeup-in etj, dhe të etiketojë ato në një postim atëherë ata duhet të ndryshojnë cilësimet e tyre në profilin publik, kjo mund t'ua lërë profilin e tyre lirshëm të jetë i parë nga të huajt.

Buy Milk

KËSHILLË PËR PRINDËRIT & KUJDESTARËT

BËJ DIALOG TË HAPUR

Flisni me fëmijën tuaj rreth transmetimeve të drejtpërdrejta dhe rreziqeve të përfshira, si dhe mundësinë sesi t'i realizojnë ato në mënyrë të sigurt me familjen dhe shoqërinë. Flisni me ta për t'u siguruar që të kenë cilësimet e sigurisë në mënyrë që vetëm ndjekësit t'i shohin ata në transmetime drejtpërdrejt dhe ndoshta t'i ndihmoni të përgatisin atë që do të thonë kur të dalin drejtpërdrejt.

FAMILJARIZU

Instagram është një aplikacion i rrjeteve sociale i cili ka veçoritë e tij të sigurisë në dispozicion të prindërve në një mënyrë miqësore për përdoruesit. Dokumenti ofron shembuj të fillimit të bisedave, menaxhimit të privatësisë, menaxhimit të komenteve, bllokimit dhe kufizimit dhe mund të gjenden në faqen e internetit të Instagram: websajti - komuniteti - prindërit. (ang. Website - Community - Parents)

MENAXHO NUMRIN E PELQIMEVE

Për shkak të ndikimit në mirëqenien mendore, Instagram lejon përdoruesit të ndryshojnë fokusin e përvojave të tyre në internet, duke fshehur numrin e pëlqimeve. Përdoruesit mund të fshehin numrin e pëlqimeve në të gjitha postimet në kryefaqen e tyre, si dhe të fshehin numrin e pëlqimeve në postimet e tyre. Kjo do të thotë që të tjerët nuk mund të shohin sa pëlqime merrni. Kjo mund të bëhet duke klikuar te cilësimet - njoftimet - postimet - pëlqimet - çaktivizo (ang. Settings - notifications - posts - likes - off)

HIQ MËNYRAT E PAGESËS

Nëse jeni të kënaqur që fëmija juaj të ketë një kartë të lidhur me llogarinë e tij në Instagram, ju sugjerojmë të shtoni një PIN që duhet të futet përpara se të kryeni një pagesë. Kjo mund të shtohet në skedën e cilësimeve të pagesës dhe gjithashtu do të ndihmojë në parandalimin e blerjeve të paautorizuara.

NDIQNI INFLUENCERËT

Ndjekja e ndikuesve do t'ju lejojë të monitoroni atë që ata shpërndajnë, si dhe të jeni në gjendje të diskutoni çdo gjë që ju e konsideroni të papërshtatshme. Flisni me fëmijën tuaj se kë ndjek dhe ndihmojeni të zhvillojë aftësi të të menduarit kritik për atë që influencersi po përpigjet ta bëjë. *Për shembull, a po përpigjet të shesin një produkt duke e promovuar atë?*

PËRDORNI MODERATORËT

Instagram ka lansuar 'moderatorët e drejtpërdrejtë' në Instagram live ku krijuesit mund të caktojnë një moderator dhe t'u japin atyre fuqinë për të raportuar komentet, për të hequr shikuesit dhe për të çaktivizuar komentet për një shikues (të caktuar). Rekomandohet t'i mbani pajisjet në hapësira të përbashkëta në mënyrë që të jeni të vetëdijshëm nëse ata po transmetojnë drejtpërdrejt ose shikojnë transmetime të drejtpërdrejta.

JENI VIGJILENT DHE TË KUFIZUAR

Flisni me fëmijën tuaj për përdorimin e filtrave. Ndërsa ato mund të jenë argëtuese për t'u përdorur, ato nuk përfaqësojnë filtrat real. Nëse e shihni që fëmija juaj vazhdimisht përdor një filtër, pyeteni përse dhe sigurojini se ai është i bukur pa të, për të rritur ndjenjat e tyre të vetëvlerësimit. Diskutoni për faktin se shumë imazhe në internet janë të filtruara dhe jo të gjithë duken si 'imazh i përsosur' në jetën reale, gjë që gjithashtu mund të jetë e dobishme për të diskutuar se çfarë është reale dhe false në internet.

BALANCOJE KOHËN TËNDE

Instagram tani ka një panel aktiviteti të integruar, që i lejon përdoruesit të monitorojnë dhe kontrollojnë sa kohë kalojnë në aplikacion. Përdoruesit mund të shtojnë një "përkujtesë ditore" për të vendosur një kufi për sa kohë duan të shpenzojnë në Instagram, duke i shtyrë ata të marrin në konsideratë nëse ka kaluar shumë kohë me një mesazh "pauzë e shkurtër". Ekziston gjithashtu opsioni për të ndaluar njoftimet për një periudhë kohore. Këto veçori mund t'ju ndihmojnë të keni një bisedë me fëmijën tuaj për sa kohë po shpenzon në aplikacion dhe për të vendosur kufij të shëndetshëm kohorë.

PENKOS

Parents Education Network of Kosovo

Përkthim dhe përshtatje